



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe të nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 15, paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinës, nenit 7, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. **Ermira Hatipi**, emërohet në pozitën këshilltare e kryetarit të kryeqytetit për qeverisje të mirë, nga data 10.01.2022.
- II. Marrëdhënia e punës e të emëruarës si në pikën I të këtij Vendimi pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit.
- III. Orari i punës për të emëruarën përcaktohet sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna.
- IV. E emëruara për punën e saj do t'i raportojë rregullisht Kryetarit.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. 14-112/01-4198/22, të dt. 10.01.2022.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Të emëruarës;
- Zyrtarit për paga;
- Njesisë së Personelit;
- Qendrës për Shërbime me Qytetar;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama